

Organet speciale dhe organizatat speciale të Kombeve të Bashkuara

Kombet e Bashkuara u krijuan në vitin 1945, për "të ruajtur brezat e ardhshëm nga kamxhiku luftës", sikurse përshkruhet edhe në fjalinë e parë të famshme të Kartës së OKB-së detyra kryesore e kësaj organizate të re. Këtu me paqe kuptohej jo vetëm mungesa e luftës, por përfshiheshin edhe - në sensin e një koncepti pozitiv për paqen - çështje të zhvillimit dhe drejtësisë ndërkombëtare. Kështu nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social bënte pjesë që në fillim në fushat e detyrave të kësaj organizate botërore.

Që të mund të realizojë këtë spektër të gjerë detyrash, Karta parashikon, që Organet kryesore të Kombeve të Bashkuara të krijojnë edhe organe dytësore dhe speciale dhe, që ato së bashku me organizata të tjera, të mund të bashkëpunojnë për realizimin e objektivave të vëna. Ky parim ka gjetur zbatim intensiv në gjashtë organet kryesore, që përbëjnë edhe thelbin e *Organizatës së Kombeve të Bashkuara*. Kështu, me kalimin e kohës, përreth kësaj bërthame lindi një rrjet i dallueshëm qartë organesh dhe bashkëpunimesh, të cilët njihen me termin *Sistemi i Kombeve të Bashkuara*. Gareis dhe Warwick e grupojnë elementet e këtij sistemi në dy kategori:

- ▶ "Së pari dallohen organet speciale, programet dhe institucionet rajonale, të cilat janë krijuar nga vetë OKB-ja dhe u nënrenditen Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Ekonomik dhe Social, respektivisht Sekretariatit
- ▶ *së dyti* dallohen edhe Organizatat e Posaçme, korporata me një natyrë juridike të tyre, të cilat janë të pavarura ose të lidhura me OKB-në me anë marrëveshjes dhe që - sikurse thuhet shpesh në mënyrë figurative - i përkasin të gjitha të njëjtës "*family of organizations*" [L.403, Bonn 2003, F. 34]



Përveç këtyre, sikurse bëhet e qartë edhe nëpërmjet diagramës, ka edhe lidhje të shumëllojshme me ekonominë (para së gjithash me Global Players, p.sh. në kuadër të "Global Compact"), me shkencën dhe me shoqërinë civile ndërkombëtare: Në Këshillin Ekonomik dhe Social janë rregjistruar më shumë se 1.500 NGO (Organizata Joqeveritare)! "Sistemi i Kombeve të Bashkuara i lindur në këtë mënyrë është një strukturë dinamike, të cilën është vërtet vështirë ta kufizosh në mënyrë të arsyeshme, ku edhe për ekspertët është pothuajse e pamundur për të patur një vështrim të plotë gjithëpërfshirës mbi veprimtaritë e tejetdegnuara."

Organet speciale të Kombeve të Bashkuara

Organet speciale vihen në veprim nga Asambleja e Përgjithshme dhe paraqesin raportin e tyre (pjesërisht direkt, pjesërisht përmes Këshillit Ekonomik dhe Social). Ato janë të lidhura në mënyrë të detyrueshme me udhëzimet dhe direktivat e Asamblesë së Përgjithshme - në dallim nga Organizatat e posaçme - dhe nuk kanë pavarësi buxhetore dhe status juridik ndërkombëtar. Por kjo nuk do të thotë, se ato nuk do të vepronin si organizata të pavarura.

Megjithë lidhjen e tyre formale me Asamblenë e Përgjithshme, vetëkuptohet që ato përkundrejt aktorëve jashtë Kombeve të Bashkuara veprojnë në mënyrë autonome, dhe kjo është arsyeja, pse ato, në raste të caktuara, cilësohen si institucione pothuajse autonome. Ato zotërojnë një strukturë të brendshme të diferencuar dhe organe politike udhëheqëse, gjë që redukton dallimin (formal) me organizatat e posaçme në lidhje me punën dhe perceptimin e aktorëve të tjerë.

Përsa i përket krijimit të tyre, Gareis dhe Varwick sqarojnë si më poshtë: "Lindja e pjesës më të madhe të organeve speciale i takon periudhës së çkolonializimit, gjatë të cilës shtetet e 'Botës së Tretë' arritën të merrnin shumicën në Asamblenë e Përgjithshme, e cila për pasojë filloi të merrej kryesisht me problemet ekonomike dhe sociale të vendeve në zhvillim (...)

Numri i konsiderueshëm i organeve speciale të krijuara në katër dekadat e para të historisë së Kombeve të Bashkuara është shprehje e revoltimit të vendeve në zhvillim kundër rendit ekonomik botëror të gjykuar prej tyre si të padrejtë, i cili i favorizon në mënyrë të njëanshme vendet e industrializuara (...). Në fakt, kështu ato ia dolën, që të përfshinin në mënyrë fikse konfliktin veri-jug në axhendën e Kombeve të Bashkuara me qëllim trajtimin e suksesshëm të tij ... por që nuk u arrit."

[nga: Sven Gareis/Johannes Varwick, *Kombet e Bashkuara. Detyrat, instrumentat dhe reformat*; Zyra Federale Qendrore Seri shkrimesh vëll.403, Bonn 2003, F. 60-61]

<i>me raportim direkt para Asamblesë së Përgjithshme:</i>			
UNRWA	United Nations Relief and Works Agency for Palestine Refugees in the Near East	Organ mbështetës i Kombeve të Bashkuara për refugjatët e Palestinës në Lindjen e Afërt	
UNITAR	United Nations Institute for Training and Research	Instituti Arsimit dhe Kërkimor i Kombeve të Bashkuara	
<i>me raportim para Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Social:</i>			
UNICEF	United Nations Children's Fund	Organ mbështetës i Kombeve të Bashkuara për fëmijët	
UNHCR	United Nations High Commissioner for Refugees	Komisioner i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët	
WFP	World Food Programme	Programi Ndërkombëtar për Ushqimin	
UNCTAD	United Nations Conference on Trade and Development	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin	
UNDP	United Nations Development Programme	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin	
UNFPA	United Nations Population Fund	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë	
UNV	United Nations Volunteers Programme	Programi i Kombeve të Bashkuara për vullnetarët	
UNU	United Nations University	Universiteti i Kombeve të Bashkuara	
UNEP	United Nations Environment Programme	Programi i Kombeve të Bashkuara për mjedisin	
WFC	World Food Council	Këshilli Ndërkombëtar për Ushqimin	
UNCHS	United Nations Centre for Human Settlements	Qendra e Kombeve të Bashkuara për sistemin e banimit dhe ngulimet	
INSTRAW	International Research and Training Institute for the Advancement of Women	Instituti Ndërkombëtar kërkimor dhe arsimor në mbështetje të gruas	
UNHCHR	United Nations High Commissioner for Human Rights	Komisioner i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e Njeriut	
ECE	Economic Commission for Europe	Komisioni Ekonomik për Evropën	
ESCAP	Economic and Social Commission for Asia and the Pacific	Komisioni Ekonomik dhe Social për Azinë dhe Paqësorin	
ECLAC	Economic Commission for Latin America and the Caribbean	Komisioni Ekonomik për Amerikën Latine dhe Karaibet	
ECA	Economic Commission for Africa	Komisioni Ekonomik për Afrikën	
ESCWA	Economic and Social Commission for Western Asia	Komisioni Ekonomik dhe Social për Azinë Perëndimore	
CERD	Committee on the Elimination of Racial Discrimination	Komiteti për eliminimin e diskriminimit racial	
CCPR /	Human Rights Committee (under	Komiteti për të drejtat e	

HRC	the International Covenant on Civil and Political Rights)	njeriut (nën Paktin Ndërkombëtar mbi të drejtat qytetare dhe politike)	
CEDAW	Committee on the Elimination of Discrimination against Women	Komiteti për eliminimin e diskriminimit të gruas	
CESCR	Committee on Economic, Social and Cultural Rights	Komiteti për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore	
CAT	Committee against Torture	Komiteti kundër Torturës	
CAAS	Commission against Apartheid in Sports	Komisioni kundër aparteidit në sport	
CRC	Committee on the Rights of the Child	Komiteti për të drejtat e fëmijëve	

Organizatat e posaçme të Kombeve të Bashkuara

Në dallim nga Organet Speciale, organizatat e posaçme nuk u krijuan nga vetë OKB-ja. Përkundrazi, këtu bëhet fjalë për organizata ndërkombëtare të pavarura juridikisht, me të cilat Kombet e Bashkuara bashkëpunojnë në bazë detyrimesh kontraktuale (Marrëveshjet e posaçme sipas nenit 63 të Kartës së OKB-së). Disa prej këtyre organizatave të posaçme - sikurse Shoqata Ndërkombëtare e Postës themeluar në vitin 1874 - ekzistonin që shumë kohë përpara se të themeloheshin Kombet e Bashkuara në vitin 1945.

Organizatat e posaçme operojnë ojesërisht në të njëjtat fusha sikurse edhe organet speciale, çka ka qenë herë pas here shkak kritikash në lidhje me efikasitetin dhe koordinimin e Kombeve të Bashkuara]. Nga pikëpamja formale, këtu bëhet fjalë për institucione ndërkombëtar, të cilat janë krijuar mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare të palëve, dëshmojnë se kanë strukturat e veta në anëtarë dhe struktura dhe posedojnë një buxhet të tyre. Ato lidhen me Kombet e Bashkuara me anë marrëveshjes, që ato i lidhin me Këshillin Ekonomik dhe Social dhe që duhet të miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Në lidhje me aktivitetin e organizatave të posaçme Gareis dhe Warwick konkludojnë: "Në mënyrë të ngjashme, sikurse në rastin e organeve speciale, edhe te organizatat e posaçme reflektohen konfliktet e interesave mes vendeve të industrializuara dhe atyre në zhvillim. Ndërsa shtetet e pasura konsiderojnë si operative dhe eficiente ato korporata financiare, ku ato dominojnë duke u nisur nga pesha e votës së tyre sipas kuotave përkatëse financiare, vendet më të varfëra u kushtojnë rëndësi organizatave për bashkëpunimin shumëpalësh për zhvillim, të cilat gjithsesi janë të varura nga mbështetja e vendeve industriale. Edhe aktiviteti i organizatave përkatëse zor se ka mundur të kontribuojë në kapërcimin e kësaj kundërshtie (...). Sikurse për Kombet e Bashkuara në tërësi, edhe për organizatat e posaçme vlen fakti, që sukcesi i punës së tyre varet kryesisht nga vullneti i shteteve, që i bartin ato, për bashkëpunim shumëpalësh."

[nga: Sven Gareis/Johannes Varwick, Kombet e Bashkuara. Detyrat, instrumentat dhe reformat; Zyra Federale Qendrore Seri shkrimesh vëll.403, Bonn 2003, F. 62]

Organizata të posaçme			
ILO	International Labour Organization	Organizata Ndërkombëtare e Punës	
FAO	Food and Agriculture Organization of the United Nations	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë	
UNESCO	United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën	
ICAO	International Civil Aviation Organization	Organizata Ndërkombëtare për Fluturimet Civile	
IBRD	International Bank for Reconstruction and Development	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore)	
IFC	International Finance Corporation	Korporata Ndërkombëtare Financiare	
IDA	International Development Association	Organizata Ndërkombëtare për Zhvillim	
IMF	International Monetary Fund	Fondi Monetar Ndërkombëtar	
UPU	Universal Postal Union	Shoqata Botërore e Postës	
WHO	World Health Organization	Organizata Botërore e Shëndetit	
ITU	International Telecommunication Union	Unioni Ndërkombëtar i Telegrafisë	
WMO	World Meteorological Organization	Organizata Ndërkombëtare për Meteorologjinë	
IMO	International Maritime Organization	Organizata Ndërkombëtare për Lundrimin Detar	
WIPO	World Intellectual Property Organization	Organizata Botërore për Pronësinë Intelektuale	
IFAD	International Fund for Agricultural Development	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor	
UNIDO	United Nations Industrial Development Organization	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial	
Organizata autonome			
WTO	World Trade Organization	Organizata Botërore e Tregtisë	
IAEA	International Atomic Energy Agency	Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike	

[Autor: Ragnar Müller]